Formulari me Udhëzime për përgatitjen e formularit të aplikimit për fazën e konceptit të projektit

1. **Të dhëna të përgjithshme**

Aplikanti:	*Emri i NJQV-së, Qarku.*
Personi/at e kontaktit:	*Emri, adresa, numri i telefonit i personit përgjegjës për mbajtjen e kontakteve në lidhje me projektin.*
Titulli i projektit	*Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konçiz dhe tu referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit.*
Vendndodhja	*Fshati, lagja, vendndodhja e saktë ku do të zbatohet projekti.*
Buxheti i kërkuar nga HAP-i	*Vendosni shumën në ALL*
Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i HAP-it	*Ju lutem lini kutinë bosh*
Numri i projektit (për t'u plotësuar nga stafi i HAP-it	*Ju lutem lini kutinë bosh*

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës së shërbimit shëndetësor parësor që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për këtë projekt/ndërhyrje në infrastrukturën fizike të QSH-së ……. ose të ambulancës..... nën QSH……..;; a është projekti i harmonizuar me nevojat më prioritare për përmirësim të infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor në NJQV-në tuaj? (jo më tepër se 1 fq.)

Paragrafi i parë jep të dhëna të përgjithshme për Njësinë e Qeverisjes Vendore, të dhëna të vednndodhjes gjeografike, klimaterike, karakteristikat bazë demografike, ekonomike etj.
Paragrafi i dytë përmban përshkrim të kujdesit shëndetësot parësor në territorin e NJQV-së tuaj, në të cilin do të kontribuojë projekti dhe gjendjen ekzistuese të shërbimit që ju po synoni të ndryshoni me anë të projektit.
Shpjegoni qartë problemin që është në qendër të projektit tuaj. Seksioni i shtjellimit të problemit jep një përshkrim të problemit (-eve) specifike që projekti përpiqet t'i zgjidhë, në mënyrë që të justifikohet nevoja për këtë projekt.
Gjithashtu, përgjigjuni çështjeve të mëposhtme:

1.1 A është objekti ku propozohet projekti pronë e bashkisë (*ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)*

1.2 A është projekti pjesë e prioriteteve afat-shkurtra të planit të Bashkisë tuaj për përmirësimin e infrastrukturës së KSHP-së i miratuar nga Këshilli i Bashkisë, i planit të *Zhvillimit Lokal apo Rajonal, apo i planit të përdorimit të tokës, planit urbanistik apo ndonjë dokumenti tjetër strategjik në nivel lokal? (ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)*

1.3 A është projekti pjesë e buxhetit afat-mesëm aprovuar nga NJQV-ja juaj? (ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)

1.4 A është projekti i miratuar nga MSHMS ose Operatori i Shërbimeve Shëndetësore? (ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)

3. Përshkrimi i projektit (jo më tepër se 1 fq.)

3.1 Titulli i projektit

Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konçiz dhe t'i referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit.

3.2 Qëllimi i projektit

Kur të formuloni qëllimin e projektit, ju lutem mbani parasysh se realizmi i projektit tuaj kontribuon në arritjen e qëllimit, por nuk e realizon plotësisht atë. Një projekt duhet të ketë vetëm një qëllim.

3.3 Objektivi/at specifikë të projektit

Objektiv/at specifikë të projektit duhet tu referohen problemit kryesor të identifikuar dhe duhen shprehur si përfitime nga përfituesit e projektit apo grupi i synuar si një rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes së projektit.

3.4 Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Rezultatet përshkruajnë produktet që u dorëzohen përfituesve të synuar të projektit.
Kjo është ajo çka projekti premton të dorëzojë. Rezultatet janë më të detajuara se objektivat dhe qëllimi i projektit; ato duhet të jenë të mundshme për t'u matur përmes përdorimit të treguesve objektivë.

3.5 Aktivitetet e projektit. Listoni aktivitetet kryesore dhe kohëzgjatjen e tyre.

Plani i aktiviteteve duhet të përmbajë informacion dhe shpjegime specifike për secilin nga aktivitetet kryesore të planifikuara. Kohëzgjatja e planifikuar e projektit dhe e aktiviteteve kryesore duhet të sqarohen mirë.

3.6 Kostoja e projektit (në ALL)

Jepni një paravlerësim të buxhetit duke treguar bazën mbi të cilën janë kryer llogaritjet (p.sh projekti i rikonstruksionit i pergatitur nga nje kompani e specializuar apo grupe ekspertesh dhe perllogaritja e kostove respektive, por edhe bazuar në aktivitete të mëparshme të kryera nga NJQV-ja juaj, projekte të ngjashme kryer nga organizata të tjera, manual çmimesh, nëse ka të tillë etj.)
Nëse ju tashmë e keni të përgatitur një analizë të detajuar të kostos, projekt preventiv apo plan, ju lutem referohuni atij dokumenti.
Tregoni buxhetin që nevojitet nga donatori dhe buxhetin që do të kontribuohet nga NJQV-ja. (Mbani parasysh limitet e buxhetit që mund të kontribuohet nga donatori) .

Vlera totale e projektit	*1=2+3*
Buxheti i kërkuar nga HAP-i	*2*
Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja	*3*

Ju lutem përshkruani si e keni llogaritur koston e projektit.

4. ***Grupet e synuar dhe përfituesit (jo më tepër se 0.5 fq.)***

Ky seksion duhet të japë një përshkrim të madhësisë dhe karakteristikave të grupit të synuar dhe në veçanti të përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit. Bëni dallimin mes përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të projektit. Jepni shifra konkrete si psh. specifikoni situatat shëndetësore dhe shifra të grup-moshave/grupeve të popullatës për të cilat shërbimet shëndetësore do të përmirësohen dhe do të jenë më të mundshme për tu ofruar ose jepni shifrën konkrete të profesionistëve shëndetësorë që do të përfitojnë kushte pune më motivuese. Jepni shifrën totale të popullsisë për të cilën shërbimi shëndetësor parësor do të bëhet më i aksesueshëm dhe më i sigurtë etj., bazuar në të dhënat, statistikat zyrtare të QSH-së, të NJLKSH-së, DRSDKSH-së, të gjendjes civile, të NJQV-së tuaj apo të institucioneve të tjera. Referohuni gjithmonë statistikave. Nëse është e nevojshme bashkëngjitni informacione shtesë.

Ju lutem përshkruani se çfarë ndikimi do të ketë zbatimit i projektit tek gratë dhe vajzat, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt dhe si gratë dhe vajzat mund të përfitojnë nga zbatimi i këtij projekti.

5. **Informacion tjetër (jo më tepër se 0,5 fq.)**

Informacion në lidhje me projektin që nuk është dhënë më sipër dhe që ju e konsideroni të dobishëm dhe të rëndësishëm. Nëse mendoni se përsëri mungon informacion i rëndësishëm dhe nuk keni hapësirë të mjaftueshme, ju mund t'i bashkëngjisni dokumente të tjerë apo ilustrime (p.sh foto, harta) formularit të aplikimit. Ju duhet t'i listoni ato më poshtë në listën e shtojcave.

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Vendimin e Këshillit të NJQV-së që vërteton se projekti është prioritet dhe mbështetet nga Këshilli bashkiak
2. Vendimin e Këshillit të NJQV-së që ka aprovuar buxhetin afat-mesëm pjesë e të cilit është dhe projekti i propozuar
3. Konfirmimin që NJQV-ja do të bashkëfinancojë projektin me të paktën 30 % të shumës totale të projektit.
4. Konfirmimin që objekti ku projekti propozohet është pronë e Bashkisë.
5. Letër konfirmimi nga MSHMS ose operatori që projekti është në përputhje me planet/strategjitë kombëtare dhe/ose rajonale të përmirësimit të infrastrukturës/zhvillimit të KSHP-së
6. [1] _____
7. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

_____

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-s

[1] Plotësohet në rast se i keni bashkangjitur shtojca të tjera aplikimit.